

**RAPORT I MONITORIMIT TË FUSHATES ZGJEDHORE 30 QERSHOR 2019**

**TË PARTISË FRYMA E RE DEMOKRATIKE**

**(Hartuar sipas formatit të standartizuar nga KQZ-ja)**

**Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Tiranë.**

Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

## **RAPORT I MONITORIMIT TË FUSHATES ZGJEDHORE 30 QERSHOR 2019,**

### **“PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019”.**

**Subjekti zgjedhor: Partia Fryma e Re Demokratike**

## **I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

### **A. INFORMACIONI LIGJOR**

#### **i. Kuadri ligjor**

- Ligji nr.10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu II Pjesa II;
- Ligji nr.8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22.05.2017;
- Udhëzimin nr.1 të KQZ-së, datë 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", i ndryshuar me vendimin nr 153, datë 11.04.2019 të KQZ-së “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr 1, datë 31.05.2017”;
- Udhëzimi i KQZ-së nr.2, datë 01.06.2017, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore”;
- Udhëzimin nr.3 të KQZ-së datë 02.06.2017 "Për përlllogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore";
- Vendimi i KQZ-së nr.152, datë 11.04.2019, “Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore”.
- Udhëzimi nr 1 të KQZ-së, datë 11.04.2019 “Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore”;

**i.a** Kohëzgjatja e misionit. Misioni i monitorimit u realizua nga data 01.06.2019 deri me 28.06.2019. Realizimi i tij është dokumentuar me 4 (katër) raportet e ndërmjetme të monitorimit, të cilat janë dorëzuar edhe elektronikisht, në format pdf, në KQZ (shpallur çdo javë dhe në faqen zyrtare të saj <http://cec.org.al/raporte-te-monitorimit-te-fushates-zgjedhore/> ), sipas kërkesave të udhëzimit nr 1, datë 11.04.2019 të KQZ-së, së “Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore”, neni 6, pika 1 e tij.

**i.b** Fushëveprimi i monitorimit. Monitorimi u krye në zbatim të kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë Politike”, i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, nenet 24/1-24/5 të tij dhe udhëzimit nr. 3 datë 2.06.2017 "Për përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore", të cilat kërkonin që eksperti financiar të moniturojë:

- Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë Politike” i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;
- Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;
- Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;
- Koston e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;
- Rregullat e brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve;
- Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj.

Monitorimi i fushatës zgjedhore u krye me anë të vëzhgimit në terren, të inspektimit, të verifikimit, të konfirmimit dhe të grumbullimit të informacionit për veprimtaritë dhe aktivitetet e subjektit zgjedhor, partia “Fryma e Re Demokratike” gjatë periudhës 01.06.2019-28.06.2019, siç është shkruar më sipër në pikën i.a.

Monitorimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 30.06.2019 për subjektin zgjedhor partia “Fryma e Re Demokratike” u realizua duke përfshirë monitorimin për aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura nga subjekti zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore në mënyrë ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale, si dhe çdo detyrim tjetër të parashikuar në kontratën e shërbimit.

## ii. **Kontrata e shërbimit.**

Kryerja e misionit të monitorimit u realizua sipas kontratës së shërbimit me numër 5048 protokollit të KQZ-së , datë 01.06.2019, të lidhur midis KQZ-së, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm i KQZ-së, z. Ylli MERKAJ dhe ekspertës financiare (audituese ligjore), znj. Hidajete Kraja (Muçaj), anëtare e IEKA-s, zotëruese e licencës së IEKA-s, me nr. 107, datë 21.12.2000, me NIPT K56424005P.

Objekti i kësaj kontrate është i përcaktuar në nenin 1 të saj, dhe ka të bëjë me kryerjen e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore të partive politike, duke përfshirë aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura prej tyre gjatë fushatës zgjedhore në mënyrë ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale si dhe çdo detyrim tjetër i parashikuar në këtë kontratë në përputhje me Kodin Zgjedhor, ligji nr.8580 datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, dhe aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim.

### iii. Vendimi i KQZ-së

Vendimi i KQZ-së nr.740, i datës 31.05.2019, “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiar dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019”, solli lidhjen e kontratës së shërbimit me numër protokollit të KQZ-së 5048, datë 01.06.2019, përshkruar më sipër në pikën ii.

- iv. Përgjegjësitë respektive të palëve, subjektit zgjedhor dhe ekspertit financiar/monitoruesit:
- Subjekti zgjedhor është i detyruar të lejoje ekspertin financiar të kryejë monitorimin në ambjentet ku ai kryen fushatën zgjedhore, dhe ti japë atij informacionet e nevojshme për qëllimet e procesit të monitorimit.
  - Eksperti Financiar merr përsipër kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në nenin 1 të kontratës, dhe të nenit 3 “Kërkesave të veçanta” të udhëzimit nr.2, datë 01.06.2017, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore”.
  - Eksperti Financiar është i detyruar të realizojë shërbimin me anë të vëzhgimit dhe grumbullimit të informacionit për veprimtari të përzgjedhura statistikiisht.
  - Eksperti Financiar duhet të hartojë raportin e monitorimit në përputhje me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, date 22.05.2017 si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre.

## B. PARAQITJA E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE STRUKTURA E TIJ

### i. Prezantimi subjektit zgjedhor

Mbas nënshkrimit të kontratës së shërbimit me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ekspertet u pajisën nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me regjistrin e subjektit zgjedhor të Partisë “Fryma e Re Demokratike”, për organet e qeverisjes vendore 2019.

Sipas regjistrin që na vuri në dispozicion KQZ-ja rezultoi se subjekti zgjedhor, Partia “Fryma e Re Demokratike”, ishte e renditur në këtë regjistër me numër rendor 29, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gyqësor Tiranë me nr. 13035 akti, dhe nr.6345 vendimi, dt.20.06.2012, me adrese selie në: Rruga “Abdi Toptani”, Tirane, me Kryetar z. Bamir Topi.

Qëllimi dhe objektivat e Partisë “Fryma e Re Demokratike”, gjejnë pasqyrim në Programin dhe Statutin e saj. Në këtë statut ajo ka rregulluar mënyren e organizimit dhe funksionimit të saj, ka përcaktuar organet drejtuese në nivel qendror dhe lokal. Aty janë përcaktuar dhe te drejtat e detyrimet e anetarësise së saj, burimet e financimit, të cilat duhet të jene ligjore si dhe rregullat e perdorimit të ketyre fondeve në dobi te aktivitetit politik të kësaj partie.

## ii. Struktura dhe objekti i raportit të monitorimit

Struktura e raportit të monitorimit është realizuar duke kaluar në 3 (tre) etapa:

- **Monitorimi i zyrave zgjedhore;**
- **Monitorimi i aktiviteteve, eventeve dhe materialeve të fushatës;**
- **Vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore nga ana e subjektit zgjedhor**

ii. **a Zyrat zgjedhore.** Partia “Fryma e Re Demokratike”, nuk ka përdorur zyra zgjedhore për fushatën elektorale.

Nga data 01.06.2019 dhe në vazhdimësi (sipas datave dhe orëve të raportuara në raportet e ndermjetme) menjëherë mbas firmosjes së kontratës me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kontaktuam me subjektin zgjedhor Partia “Fryma e Re Demokratike”, nepërmjet adreses elektronike [info@frd.al](mailto:info@frd.al), adresë kjo e publikuar si adresë zyrtare. Nga takimet e mëvonshme u sqarua se kjo adresë nuk ishte bërë akoma aktive nga shoqëria që kryente mirmbajtjen e saj, në vijim kemi komunikuar me adresën [sekretaria@frd.al](mailto:sekretaria@frd.al) e cila u bë aktive me datën 11.06.2019.

Në këtë email, kam kërkuar të takohem me personat që kanë përgjegjësinë e komunikimit me ekspertin financiar, për t`u prezantuar dhe për t`ju bërë të ditur se kane detyrimin ligjor, të më lajmerojnë për cdo aktivitet të fushatës zgjedhore, që do të kryhet nga ana e tyre.

Po në këtë email kam kërkuar të më dërgojnë informacion për zonat elektorale dhe emrat e kandidatëve me qëllim hartimin e kërkesave pranë Bashkive perkatese.

Me datën 03.06.2019 jam paraqitur në selinë e partisë, ambjenti i të cilave ishte në Rrugën “Abdi Toptani”, Tiranë, dhe kam komunikuar me sekretarin e përgjithshën z.Sali Shehu.

Gjatë këtij takimi kam kërkuar të më vihen në dispozicion informacione dhe dokumenta që kanë të bëjnë me:

- 
- Adresat e të gjitha zyrave elektorale të Partisë “Fryma e Re Demokratike” në të gjithë territorin e vendit, sipas bashkive përkatëse, sipërfaqen, pronësinë, kontratën e qirasë apo çdo dokument që rregullon marrëdhënien e përdorimit nga subjekti zgjedhor të ambjentit që shërben si zyre elektorale.
  - Listën e aktiviteteve që ka planifikuar të zhvillojë deri në përfundim të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, viti zgjedhor 2019, adresën e zhvillimit të aktivitetit.
  - Projekt buxhetin që subjekti zgjedhor “Fryma e Re Demokratike”, ka hartuar për fushatën zgjedhore, të organeve të qeverisjes vendore, qershor 2019.
  - Dokumentacionin financiar mbi shpenzimet e realizuara nga subjekti zgjedhor “Fryma e Re Demokratike” për fushatën zgjedhore 2019 dhe nëse kishin llogari bankare të hapura posaçërisht për fushatën.
  - Listën e kandidatëve për kryetarë të bashkive dhe këshilltarë bashkiakë.
  - Etj.

Në takimin e datës 03.06.2019 z. Sali Shehu u shpreh, se partia “Fryma e Re Demokratike” nuk do të zhvillojë fushatë elektorale, nuk kemi ngitur staf vezhgues për ditën e zgjedhjeve, nuk do të zhvillojmë aktivitete dhe nuk do të shpenzojmë fonde për materiale propogandistike apo mitinjgje. Në këtë deklaratë u konfirmua se partia “Fryma e Re Demokratike,” nuk do të marrë me qira asnjë ambjent për ta përdorur si zyrë elektorale gjatë fushatës zgjedhore. Selia e partisë është e vetmja zyrë për aktivitetin normal të partisë e marrë me kontratë huapërdorje nga Bashkia e Tiranës. Kontratata e huapërdorjes është lidhur mes palëve me nr 5716/2 prot, datë 23.03.2016 me, për një sipërfaqe 200 m2, në rrugën Abdi Toptani”, Tiranë, në bazë të kërkesave ligjore të nenit 22/1 të ligjit nr.8580 datë 17.12.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar. Gjatë këtij takimi na u vu në dispozicion lista e kandidatëve për antarë të këshillave bashkiake si dhe bashkitë ku ato do të kandidonin.

Në datën 07.06.2019 dhe me dt.10.06.2019 ne ju drejtuar me kërkesë zyrtare (kërkesë e dërguar me poste rekomande) Kryetarëve të 61 Bashkive në vend, për të na informuar në lidhje me adresat e sakta të zyrave elektorale per Subjektin zgjedhor "FRD", në zbatim të kërkesave të Udhezimit të KQZ Nr. 1, date 31.05.2017, gjithashtu këto kërkesa në drejtim të bashkve, i realizuam edhe në portalin [www.pyetshtetin.al](http://www.pyetshtetin.al) ku aksesimi për të marrë informacion me kërkesë zyrtare ishte vetëm për 7 bashki, përgjigjet e të cilave janë deklaruar në raportin e ndërmjetëm nr.1 dt.10.06.2019.

Me datën 11.06.2019 në adresën [sekretaria@frd.al](mailto:sekretaria@frd.al) ne derguam raportin e monitorimit të datës 10.06.2019 dhe kërkuam të na vihet në dispozicion lista e kandidatëve që kanë kandiduar për antarë të keshillit bashkiak, të njoftohemi nëse ka aktivitete për fushatën, nëse kanë të hapur llogari bankare për donacionet e fushatës si dhe nëse kanë kryer shpenzime për fushatën.

FRD-ja me anë të email [sekretaria@frd.al](mailto:sekretaria@frd.al) me dt.11.06.2019 na dërgoj një liste me emrat dhe kontaktet e një kandidati për cdo bashki ku FRD-ja është miratuar nga KQZ-ja për të kandiduar në zgjedhjet vendore 2019. Gjatë monitorimit në terren u bënë verifikimet përkatëse nëse personat kandidat të FRD-së kanë aktivitete elektorale me emrat e tyre ose në emër të partisë FRD.

Po me datë 11.06.2019, për të marrë një përgjigje më të shpejtë nga bashkitë e vendit, referuar emailve të publikuara në portalin <https://pyetshtetin.al/category/kategorite/pushteti-vendor/> janë dërguar 41 (dyzet e një) dhe emaille të gjetura në internet për 3 (tre) bashki të tjera, gjithsej janë dërguar 44 (dyzet e katër) emaille.

Me datën 17.06.2019 u ridërguan me postë 3 (tre) zarfa për bashkitë Divjakë, Maliq, Memaliaj sepse kërkesa dërguar për herë të parë këtyre bashkive nuk ishte e firmosur dhe e vulosur nga ana e jonë dhe për këtë arsye nuk na mundësuan përgjigje.

Në raportin e 4 (katërt) të ndërmjetëm u bë një përmbledhje e përgjigjeve të marra nga bashkitë e vendit sipa të cilave rezultoj se nga 61 shkresa të dërguara në bashkitë e vendit, nga të cilat kemi kërkuar informacion kanë kthyer përgjigje 49 bashki me shkresë, me email ose edhe me shkresë edhe me email, ndërsa 12 bashki nuk kanë kthyer përgjigje. Tabela nr.1 tregon listen e bashkive që kanë kthyer përgjigje, me shkresë, me email ose edhe me shkresë edhe me email.

### **Tabela nr.1**

<b>Nr</b>	<b>Bashkia</b>	<b>Përgjigje me poste ose email</b>	<b>Permbajtja e përgjigjes</b>
1	Belsh	Shkresë me poste nr 1968/1 prot dt.18.06.2019	Nuk ka hapur zyra elektorale
2	Berat	Email 12.06.2019 nertilakadena@bashkiaberat.gov.al	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
3	Delvinë	Email dt 14.06.2019 bashkia.delvine@hotmail.com	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
4	Devoll	Shkresë me poste nr 1928/1 prot dt.12.06.2019	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
5	Dibër	Email dt.17.06.2019 bashkiadiber@gmail.com	Fryma e Re Demokratike, nuk ka depozituar asnje informacion
6	Divjake	Shkresë me poste nr 2460/1 prot dt.24.06.2019	Nuk ka zyre elektorale
"	Divjakë		Shkresë e kthyer pa përgjigje per shkak te mungeses së firmës, ridërguar me dt.17/06/2019
7	Dropull	Shkresë me poste nr 354/1 prot	Nuk ka hapur zyra elektorale

		dt.12.06.2019	
8	Durrës	Email 13.06.2019 kabinet@durres.gov.al	FRd nuk ka sjelle informacion për zyra elektorale
9	Elbasan	Shkrese me poste nr 4529/1 prot dt.25.06.2019	Nuk ka hapur asnje zyre elektorale dhe nuk ka praqitur kerkesë
10	Fier	Emali date 17.06.2019 nbocova@yahoo.com	FRd nuk ka sjelle informacion për zyra elektorale
11	Fushë-Arrëz	Shkrese me poste nr 1818/1 prot dt.12.06.2019 mberrit me poste me 27.06.2019	Nuk ka hapur asnje zyre elektorale ne territorine bashkise Fushë-Arrëz
12	Gjirokaster	Shkrese me poste nr 4300/1 dhe 4310/1 prot dt..24.06.2019	Nuka ka informacion nga FRD per zyra elektorale
13	Gramsh	Shkrese me poste nr 3829/1 prot dt.18.06.2019	Nuk ka hapur zyra elektorale
14	Has	Email me dt 18.06.2019	Nuk kane informacion nga FRD per zyrat elektorale.
15	Himare	Poste me date 17.06.2019 Nr.1713/1 prot	Nuk rezulton te kete hapur zyra elektorale
16	Kamëz	Me emali date 11.06.2019 dodaervin007@gmail.com	Nuk ka zyre elektorale
"	Kamëz	Shkrese me poste nr 3182/1 prot dt.21.06.2019 mberrit me poste me 27.06.2019	Shkresa nuk përçaton përgjigjen për zyrat elektorale
17	Kavaje	Shkrese me poste nr 1931/11 prot dt.14.06.2019	Nuk ka hapur zyra elektorale
18	Këlcyrë	Shkrese me poste nr.1333 prot dt.12.06.2019, email 12.06.2019 bashkia.kelcyre1@gmail.com	Nuk ka zyre elektorale
19	Klos	Shkrese me poste nr 1327/1 prot dt.11.06.2019	Aktualisht nuk ka zyra elektorale
20	Kolonje	Emai dt.21.06.2019 thomazisi12@gmail.com, bashkangjitur shkresa me Nr.1976/1 Prot. Dt.21.06.2019 dhe me poste date 22.06.2019	Nuk ka zyre elektorale ne territorin e bashkise Kolonje
21	Konispol	Shkrese me poste nr 829/1 prot dt.12.06.2019 edhe email.	Partia FRD nuk ka bërë asnjë njoftim për zyra
22	Korçë	Shkrese me poste nr 4967/1 prot dt.13.06.2019	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
23	Kruje	Poste me date 17.06.2019 Nr.4352 prot	Nuk ka hapur zyra elektorale
24	Kuçovë	Shkrese me poste nr 2049/1 prot dt.12.06.2019	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
25	Kurbin	Pergjijge me email bashkia_lac@yahoo.com dt 19.06.2019 me shkrese nr.3053 prot dt 13.06.2019, Poste me date 18.06.2019 Nr.3053/1 prot	Nuk ka asnje zyre elektorale
26	Libohovë	Email 12.06.2019 bashkialibohove@autlook.com	Nuk ka zyra elektorale
27	Lushnje	Emai dt.13.06.2019 celalidjona@yahoo.com	Ne pritje te nje pergjigjeje.
"	Lushnje	Emai dt.21.06.2019 celalidjona@yahoo.com	Ka qene ne pritje te nje pergjigjeje. Nuk ka zyre elektorale ne territorin e bashkise Lushnje
28	Malesi e Madhe	Shkrese me poste nr 3292 prot dt.19.06.2019	Nuk ka zyre elektorale ne territorin e bashkise M.Madhe



29	Maliq		Shkrese e kthyer pa pergjigje per shkak te mungeses së firmës, riderguar me dt.17/06/2019
"	Maliq	Shkrese me poste nr 2771/1 prot dt.21.06.2019	Nuka ka informacion nga FRD per zyra elektorale
30	Mallakastër	Shkrese me poste nr 1328/1 prot dt.12.06.2019	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
31	Mat	Email me dt.25.06.2019 bashkangjitur shkresa por pa date, Shkrese me poste nr 1706 prot dt.26.06.2019	Nuk rezulton të ketë zyra elektorale
32	Memaliaj		Shkrese e kthyer pa pergjigje per shkak te mungeses së firmës, riderguar me dt.17/06/2019
"	Memaliaj	Shkrese me poste nr 695/1 prot dt.21.06.2019	Ishte shkrese e kthyer pa pergjigje per shkak te mungeses së firmës, riderguar me dt.17/06/2019.Pergjigjja perfundimtare nuk ndodhen zyra elektorale ne bahkine Memaliaj
33	Mirditë	Shkrese me poste nr2452/1 prot dt.12.06.2019 email 13.06.2019	Nuk ka zyre elektorale
34	Patos	Shkrese me poste nr 1684/1 prot dt.17.06.2019	Nuk ka hapur asnje zyre elektorale ne territorine bashkise Patos
"	Patos	Emai dt.21.06.2019 beqirajshkelqim@yahoo.com bashkangjitur shkresa me Nr.1684/1 Prot. Dt.17.06.2019	Nuk ka zyre elektorale ne territorin e bashkise Patos
35	Peqin	Shkrese me poste nr 1369/1 prot dt.19.06.2019	Nuk disponon Zyre elektorale
36	Përmet	Email 12.06.2019 robert.nano54@yahoo.com	Nuk ka njoftim nga partia.
37	Pogradec	Shkrese me poste nr 4492/14 prot dt.13.06.2019	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
38	Poliçan	Shkrese me poste nr 1504/1 prot dt.11.06.2019	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
39	Pukë	Shkrese me poste nr 934/1 prot dt.10.06.2019	Nuk kane informacion per zyrat elektorale
40	Pustec	Shkrese me poste nr 517/1 prot dt.17.06.2019	Nuk ka bere njoftim zyrtar prane kryetarit te bashkise Pustec
41	Roskovec	Shkrese me poste nr 3372 prot dt.12.06.2019	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
42	Shijak	Shkrese me poste nr 1981/1 prot dt.13.06.2019	Nuk kane informacion per zyrat elektorale
43	Shkoder	Shkrese me poste nr 9882 prot dt.19.06.2019	Ka qene ne pritje te nje pergjigjeje. Nuk ka bere asnje kerkese per zyre elektorale
"	Shkodër	Email 11.06.2019 mpubliku@bashkiashkoder.gov.al	Per trajtimin e kerkeses suaj jane duke e marre drejtorite perkatese
44	Skrapar	Shkrese me poste nr 1766/1 prot dt.11.06.2019	Nuk ka njoftim me shkrim per zyrat elektorale
45	Tepelenë	Shkrese me poste nr 940/1 prot dt.12.06.2019 edhe email dt.12.06.2019 kleonabahja@gmail.com	Nuk eshte subjekt zgjedhor I rregjistruar prane KZAZ 77
46	Tirane	Shkrese me poste nr 23902/1 prot dt.18.06.2019	Nuka ka informacion nga FRD per zyra elektorale

"	Tiranë	Email me dt 11.06.2019, 17.06.2019 elena.xhaxho@tirana.gov.al halil.rama@tirana.al, Shkrese me poste nr 23902/1 prot dt.18.06.2019	Nuka ka informacion nga FRD per zyra elektorale
47	Tropojë	Email me dt 12.06.2019 dhe shkrese me poste nr.1775/1 prot dt.13.06.2019 jutbinaqeleshposhi@gmail.com	Nuk kane informacion nga FRD per zyrat elektorale.
48	Urë Vajgurore	Shkrese me poste nr1497/1 prot dt.11.06.2019	Nuk ka zyre elektorale ne territorin e Bashkia Ura Vajgurore
49	Vlore	Shkrese me poste nr 1845/1 prot dt.14.06.2019 dhe 5035/1 prot dt.17.06.2019	Nuk ka adrese te deklaruar ne Bashkine Vlore per zyre elektorale

Tabela nr. 2 tregon listen e bashkive që nuk kanë kthyer përgjigje. **Tabela nr.2**

Nr	Bashkia	Pa pergjigje
1	Bulqizë	Pa pergjigje
2	Cërrik	Pa pergjigje
3	Finiq	Pa pergjigje
4	Kukës	Pa pergjigje
5	Lezhë	Pa pergjigje
6	Librazhd	Pa pergjigje
7	Prrenjas	Pa pergjigje
8	Rrogozhine	Pa pergjigje
9	Sarandë	Pa pergjigje
10	Selenice	Pa pergjigje
11	Vau I Dejës	Pa pergjigje
12	Vorë	Pa pergjigje

Nga verifikimi i përgjigjeve të mbërritura nga 49 bashki, rezulton se partia Fryma e Re Demokratike, nuk ka lajmëruar asnjë nga bashkitë e vendit për hapje të ndonjë zyre elektorale ndërsa nga 12 bashki që nuk kanë kthyer përgjigje 11 prej tyre partia "FRD" nuk ka kandidaturë as për kryetar e as për antarë të këshillit bashkiak, e vetmja bashki ku partia "FRD" ka kandidu për antarë të këshillit bashkiak prej të cilës nuk kemi marrë përgjigje është bashkia e Librazhdit.

## PËRFUNDIM 1

Sipas verifikimeve të kryera në terren në të gjitha bashkitë ku partia "Fryma e Re Demokratike" kishte depozituar listat kandidatët e saj për këshilltarë bashkiakë dhe sipas përgjigjeve të kthyer zyrtarisht nëpërmjet Postës Shqiptare dhe nëpërmjet portalit <https://pyetshtetin.al/category/kategorite/pushteti-vendor/page/11/> rezulton që subjekti elektorale, partia "Fryma e Re Demokratike", nuk kishte zyra elektorale të sajat, për fushatën zgjedhore, për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Të gjitha këto rezultate i keni të shprehura në raportet e ndërmjetme javore (të dokumentuara me fotot përkatëse të ambjenteve të 18 bashkive ku shihet që nuk ka zyra elektorale) që janë shpallur dhe në faqen zyrtare të KQZ-së <http://cec.org.al/raporte-te-monitorimit-te-fushates-zgjedhore/>).

V.O: Të gjithë këtë korrespondencë e gjeni të përmbledhur në tabelën nr.1. Të gjitha përgjigjet të mbërritura në rrugë postare ose me email janë skanuar dhe i janë bashkangjitur raporteve të ndërmjetme të periudhave përkatëse. Të gjitha fotot e realizuara në 18 bashkitë e monitoruara i gjeni tek dokumenti që i bashkëngjitet këtij raporti: Përmbledhëse e fotove të realizuara në 18 bashkitë ku partia.docx

## ii. b Aktivitetet, eventet dhe materialet e fushatës të partisë “Fryma e Re Demokratike”.

FRD-ja me anë të një emaili nga adresa [sekretaria@frd.al](mailto:sekretaria@frd.al) me dt.21.06.2019 na dërgoj një deklaratë në formë shkresore lidhur me çështjet për të cilat ne kemi kërkuar informacion. Në këtë deklaratë kryesia e partisë shprehet se:

- nuk kemi tërhequr asnjë fond deri më sot nga buxheti i shtetit për fushatën e zgjedhjeve vendore 2019.
- nuk kemi bërë asnjë shpenzim gjatë muajit qershor me arkë dhe me banke.
- nuk kemi hapur llogari te dytë bankare per zgjedhjet e dates 30 qershor 2019.
- nuk kemi marrë asnjë donacion nga asnjë kompani a individ.
- nuk kemi porositur asnjë material propogandistik.
- nuk kemi porositur asnjë shërbim dhe s`kemi lidhur asnjë kontratë për mallra e shërbime kështu që nuk kemi asnjë detyrim.
- kandidatët tanë nuk janë duke zhvilluar fushate me mitingje a takime.

Deklarata e bërë nga drejtuesit e FRD-së i është bashkangjitur raportit të ndërmjetëm nr. 3 datë 24.06.2019. Nga ana e jonë u bënë verifikime të dokumentacionit kontabël të FRD-së dhe nuk u konstatuan shpenzime të vecanta për fushtaën elektorale zgjedhjet vendore 2019, përvec shpenzimeve që ka në aktivitetin e saj të zakonshëm si paga, sigurime, komisione, mirmbajtje, kompjutera etj.

## PËRFUNDIM 2:

**Gjate monitormit të fushatës zgjedhore të kësaj partie arritëm nuk gjetëm raste:**

- të realizimit të aktiviteteve apo mitingje për fushatën elektorale.
- të kryerjes së shpenzimeve për materiale të fushates zgjedhore si fletushka, banderola, reklama, flamuj, etj.

## ii. c Vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore nga ana e subjektit zgjedhor.

### Përfundim 3

**Nuk janë evidentuar raste të mosrespektimit të kërkesave ligjore nga subjekti zgjedhor.**

**iii. Përmendja e takimeve dhe komunikimeve të mundshme midis ekspertit financiar dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.**

Takimet dhe komunikimet me subjektin zgjedhor janë realizuar me sekretarin e përgjithshëm të partisë z. Sali Shehu dhe me zj. Aleksandra Trebicka, si dhe me anë të adresës elektronike [sekretaria@frd.al](mailto:sekretaria@frd.al).

**iv. Paraqitja e përgjithshme në lidhje me raportin e monitorimit**

**IV. Konkluzione mbi Monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore**

Në lidhje me procesin e monitorimit për zgjedhjet e organeve vendore të datës 30.06.2019 për Partinë "Fryma e Re Demokratike" në funksion të objektit të kontratës së shërbimit dhe në zbatim të udhëzimit nr.2 të KQZ-së, datë 01.06.2017, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore, neni 3, në raportojmë konkluzionet në vijim:

- a) Në mbështetje të nenit 24/4, pika 1, të ligjit nr.8580, dt.17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.90/2017, udhëzimit të KQZ-se nr.1, dt.31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propogandistike dhe vendet e afishimit të tyre gjatë fushatës zgjedhore", ndryshuar me vendimin nr. 153 të KQZ-së, datë 11.04.2019, rezulton që subjekti zgjedhor, partia "Fryma e Re Demokratike" nuk ka respektuar detyrimin ligjor që jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve të njoftojë me shkrim kryetarin e bashkisë përkatëse për adresat e sakta të zyrave elektorale.  
Partia "Fryma e Re Demokratike" nuk ka zyra elektorale të hapura për fushatën zgjedhore, nuk disponon kontrata qiraje apo kontrata përdorimi me individë që do të donin të vinin në dispozicion të saj ambiente të tyre. Gjithashtu nuk ka dhe deklarata të lëshuara prej individëve për kontributin që do të donin të ofronin si dhe nuk ka kosto qirajeje të llogaritura si detyrime për zyra elektorale.
- b) Në lidhje me zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike", i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 rezulton që nuk u konstatuan shkelje të ligjit në lidhje me financimin e fushatës elektorale.
- c) Në lidhje me dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor, gjatë monitorimit u vërejt që subjekti zgjedhor nuk disponon dokumentacion ligjor për këtë qëllim meqë nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet elektorale për zgjedhjet e organeve vendore të datës 30.06.2019.
- d) Në lidhje me respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propogandistike dhe reklamave televizive, rezulton që

gjatë monitorimit nuk u konstatua tejkalim i kufirit maksimal të shpenzimeve meqë nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet elektoral për zgjedhjet e organeve vendore të datës 30.06.2019

- e) Në lidhje me kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruar nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit, nga partia “Fryma e Re Demokratike” u paraqit një deklaratë me datë 21.06.2019 me shpjegimin që Partia nuk ka pasur dhe nuk ka synim të zhvillojë fushatë elektorale. Dhe gjatë monitorimit nuk u konstatuan shpenzime të kryera në funksion të fushatës elektorale.
- f) Në lidhje me rregullat e brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve, nga monitorimi i dokumentacionit financiar dhe i dokumentit “informacion për subjektin zgjedhor, përmbledhje financiare dhe deklarata” të përgatitura nga subjekti zgjedhor partia “Fryma e Re Demokratike”, nënshkruar nga drejtuesit e partisë me datë 25.09.2019 dhe shpallur në faqen zyrtare të KQZ-së [http://cec.org.al/ep-content/uploads/2019/10/Partia-Fryma e Re-Demokratike-e-Shqiperise-14102019155721.pdf](http://cec.org.al/ep-content/uploads/2019/10/Partia-Fryma-e-Re-Demokratike-e-Shqiperise-14102019155721.pdf), nuk u konstatua shkelje në lidhje me raportimin e shpenzimeve.
- g) Në lidhje me transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike, theksojmë që nga partia “Fryma e Re Demokratike” nuk ka pasur transaksione financiare të pajustificuara, që mund të jenë përdoruar për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore.

## II. PËRMBLEDHJE / KËRKESAT FORMALE

### A. PËRMBLEDHJE

1/ Identifikimi i subjektit zgjedhor në raportin e monitorimit		
a) identifikimi i subjektit zgjedhor (partia, kandidati/ja)	Po	Partia Fryma e Re Demokratike
b) identiteti i personit përgjegjës për financat	Po	Nuk ka një person të veçantë që merrej vetëm me financat, por personi që më vuri në dispozicion dokumentat financiare ishte zj. Aleksandra Trebicka.
c) evidenca e çeljes së llogarisë bankare	JO	Nuk ka llogari bankare të hapur për fushatën zgjedhore 2019
d) paraqitja e deklarimeve bankare që mbulojnë periudhën e fushatës	Po	Deklarata bankare ka vetëm për llogarinë rrjedhëse të aktivitetit normal të partisë por që nuk ka transaksione që lidhen me fushatën zgjedhore qershor 2019
2/ Nënshkrimi dhe data e paraqitjes së raportit të monitorimit		
Eksperti financiar	Po	Hidajete Kraja (Muçaj)

Nënshkrimi	Po	26.11.2019
Dorëzimi i raportit të monitorimit	Po	26.11.2019
<b>3/ Aktivitetet, eventet dhe materialet e monitoruara</b>		
a) Zyrat zgjedhore	Jo	Nuk ka zyra zgjedhore, e vetmja zyrë selia e partisë Rruga Abdi Toptani, Tiranë.
b) Respektimi i ndalimit të aktiviteteve zgjedhore edhe nga ana e bashkive.	Jo	Nuk ka
c) aktivitetet	Jo	Nuk ka
d) eventet		Nuk ka
e) materialet propagandistike		Nuk ka

## B. ANALIZA

### a/ Kërkesat formale

#### - Llogari bankare e veçantë

- Partia “Fryma e Re Demokratike,” nuk ka hapur një llogari bankare të veçantë për fushatën zgjedhore dhe nuk ka marrë marrë donacione që e kalojnë shumën prej 100,000 Lekë.
- Subjekti duhej të hapte një llogari bankare të veçantë për fushatën zgjedhore në zbatim të ligjit. Nuk ka një evidencë për hapjen e kësaj llogarie, përveç llogarisë bankare që ajo ka gjatë aktivitetit të zakonshëm të jetës politike që ajo zhvillon pranë Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) me IBAN: AL4320511265668071CLTJCLALLD
- Nuk ka deklarime bankare që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.
- Personi përgjegjës i financave sipas regjistrit të partive politike që na është vënë në dispozicion nga KQZ-ja është Afrim Ismaili, por nuk merrej me dokumentat financiare meqëse edhe veprimet ishin veprime të administrimit të zyrës ku ndodhej selia e partisë. Dokumentat financiare më janë vënë në dispozicion nga zj. Aleksandra Trebicka.

#### - **Theksim çështje: Nga partia politike nuk zbatohet ligji për hapjen e llogarive bankare posaçërisht për fushatën zgjedhore.**

#### - Procedura verifikimi

- Shkëmbim informacioni ndërmjet personit përgjegjës për financat/ partinë/ kandidatin/ çdo person fizik apo juridik.
- Nga komunikimi me Partinë “Fryma e Re Demokratike” kam marrë dokumenta, dhe informacione financiare sipas të cilave nuk ka financime dhe shpenzime për fushatën zgjedhore. Nuk është hapur llogari bankare e veçantë për fushatën zgjedhore qershor

2019. Faturat e blerjes dhe pagesat kanë lidhje me shpenzimet e administrimit të selisë së partisë dhe nuk kam dokumentacione, informacione që lidhen me shpenzime për mitingje, konferenca, takime e të ngjashme. Në mbështetje të këtij dokumentacioni financiar është edhe deklarata e z.Sali Shehu se partia "Fryma e Re Demokratike" nuk ka zhvilluar asnjë lloj aktiviteti në lidhje me fushatën zgjedhore qershor 2019 si për donacionet ashtu edhe për shpenzimet.

- Nuk kam informacione nga bankat dhe institucionet e tjera financiare dhe palët e treta, për shpenzime dhe donacione të përfituara nga partia "Fryma e Re Demokratike".

Nuk kam informacion për denoncime dhe ankesa të mbërritura në KQZ, që kanë të bëjnë me shpenzimet e fushatës zgjedhore të zhvilluara nga partia "Fryma e Re Demokratike", " (shih [http://cec.org.al/zgjedhjet-vendore-2019/#tabs\\_desc\\_30495\\_6](http://cec.org.al/zgjedhjet-vendore-2019/#tabs_desc_30495_6)).

### 1. Listat e kontrollit/ Tabela e raportimit

Listat kontrolluese (checklistat) janë përdorur për regjistrimin e vëzhgimeve dhe llogaritjeve / vlerësimeve që kanë të bëjnë me elementet individuale të fushatës, të cilat janë dorëzuar në raportet e ndërmjetme gjatë fushatës zgjedhore. Këto lista kontrolli janë përdorur për të mbledhur të dhënat dhe informacionet që u paraqitën në këtë raport përfundimtar të Monitorimit. Ato u përdoren për të gjeneruar

- i. gjetje për raportet javore të dorëzuara në KQZ dhe
- ii. për të bërë një përmbledhje të konsoliduar të gjetjeve të monitorimit.

**Lista 1: Zyrat elektorale.** Nuk ka gjetje për ekzistencën e zyrave elektorale për llogari të partisë "Fryma e Re Demokratike", që mund t'i vëzhgonim dhe monitoronim për numrin e tyre në përputhje me limitin e zyrave zgjedhore të përcaktuara me Udhëzimin Nr. 1 të KQZ-së të datës 31.5.2017.

Bashkia	Dibër, Durrës, Elbasan, Kamëz, Këlcyrë, Klos, Korçë, Kukës, Lezhe, Librazhd, Malësi e Madhe, Mirditë, Pogradec, Pukë, Shijak, Shkodër, Tiranë, Vlorë			
Adresa				
Data dhe koha e vëzhgimit	01 qershor deri 28 qershor 2019			
Madhësia e zyrës elektorale	Ska zyra elektorale			
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore")			Shif tabelat nr 1, 2 Pika ii.a	

Ekzistenca e një kontrate qiraje / marrëveshje qiraje				ska
Numri i stafit të vëzhguesve	Nuk ka			
Pajisjet e vërejtura	Nuk ka			
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	Nuk ka			

**Theksim ceshtjet:** Nga procedurat e kryera për verifikimin e ekzistencës së zyrave elektorale u konstatua se partia “Fryma e Re demokratike” nuk ka hapur zyra elektorale dhe në këto kushte nuk ka njoftuar asnjë bashki për adresat e këtyre zyrave, përgjigjet e 49 bashkive konfirmojnë se nuk kanë njoftim nga kjo bashki.

### Lista 2: Materiale propagandistike të fushatës zgjedhore të ndaluara (palejuara)

Bashkia	Dibër, Durrës, Elbasan, Kamëz, Këlcyrë, Klos, Korcë, Kukës, Lezhe, Librazhd, Malësi e Madhe, Mirditë, Pogradec, Pukë, Shijak, Shkodër, Tiranë, Vlorë			
Data dhe koha e vëzhgimit	01 qershor deri 28 qershor 2019			
Vendosja e materialeve propagandistike më shumë se 5 metra nga zyra zgjedhore			Jo	
Materialet e vërejtura				
Fotografitë e marra			Jo	
Tipi	Vendndodhja	Numri	Kostoja e parashikuar	
p.sh postera, banera, flamuj				
Etj.				

Subjekti zgjedhor Partia “Fryma e Re Demokratike”, referuar fotove të rapartuara në raportet e ndermjetme të monitorimit nuk ka përdorur materiale propagandistike të fushatës zgjedhore, pra nuk ka as shkelje të përdorimit të Materialeve propagandistike të fushatës zgjedhore të ndaluara në përputhje me Udhëzimin Nr. 1 të KQZ-së të datës 31.5.2017.

### Lista 3: Aktivitetet e fushatës

Partia/ Kandidati	Partia Fryma e Re Demokratike”		
Lloji i eventit	Nuk janë realizuar evente, meetingje, konferenca etj		
Vendi dhe koha e fushatës	Në asnjë qytet		
Vendtakimi për fushatën zgjedhore	Nuk janë përdorur objekte të bashkisë dhe raste abuzime.	Lokacioni - ambiente publike	Nuk janë zhvilluar meetingje nga Partia FRD, por takime Pa kosto



Madhësia dhe kapaciteti i vendit	N/A			
Numri i pjesëmarrësve	Numri (llogaritet ose vlerësohet - p.sh. bazuar në numrin e njerëzve në rresht)			3 - 4
Stafi organizues	Stafi i partisë ose kandidatëve ose vullnetarët	Stafi i paguar, i siguruar nga kompania	Të tjerë	
Pije të ofruara	Përshkrimi (uji, pijet joalkoolike ...) dhe vlerësimi i përafërt i sasisë			Nuk ka deklarime dhe nuk kemi patur shansin të monitorojmë një takim në bar kafe.
Ushqimi i ofruar	Përshkrimi (sanduiçe, enët, ëmbëlsira, etj) dhe vlerësimi i përafërt i sasisë			Nuk ka
Argëtimi	Person (këngëtar, atlet, aktor, etj)			Nuk ka
Transporti (për çdo automjet)	Qëllimi (transportimi i pjesëmarrësve, materialeve, të ftuarve, zyrtarët e partisë dhe kandidatët)	Tipi (autobusë, furgona, makina)		Nuk ka
Mobilje dhe sistemi audio	Karrige	Tavolina	Video dhe sistemi audio	Të tjera
Dhurata promovionale	Lloji (Bluza, stilolapsa, paratë, të tjera)		Sasia (e vlerësuar)	Nuk ka
Komente të tjera. Deklarimet e drejtimit të partisë janë se nuk ka snjë shpenzim për fushatën vëtenë në raste kur kandidati i realizon ato pa dijeneinë tonë.				

Nuk ka aktivitete të kryera për llogari të fushatës si mitingje, materiale promovionale, s'ka as pije, as ushqime dhe as argëtime të ofruara prej partisë "Fryma e Re Demokratike".

MONITORUESE

EKSPERTE FINANCIARE/AUDITUESE LIGJORE

HIDAJETE KRAJA (MUÇAJ)

Shkodër me dt26.11.2019